


Jo Vetëm një Ditë e Mirë

Stërvitjeje



Nga Karolina Maldonado Lejesi

(Bazuar në një ngjarje të vërtetë)

Kjo histori ndodhi në Bolivi.

Ismaeli buzëqeshi ndërsa doli jashtë në rrezet e diellit. Ai dhe Papá [babi] po shkonin në park. Ndërsa ecnin, Ismaeli kishte kapur Papán për dore dhe mbante topin e tij të futbollit. Ismaelit i pëlqente të kalonte kohë me Papán, veçanërisht kur luanin futboll!

Kur arritën në park, Ismaeli vështroi përreth. Një zonjë po shkulte barin e keq pranë fushës së futbollit. Një familje po ecte në trotuar. Por askush nuk po luante në fushën e futbollit. Ismaeli dhe Papá do të kishin gjithë atë vend për t'u stërvitur!

"Gati për të luajtur?" – pyeti Papá.

"Po!" Ismaeli vrapoi sa më shpejt që mundi drejt fushës. Ai bëri kalim piketash me zigzage, gjuajtje penalltish dhe goditje nga këndi.

Papá e gjuajti topin fort. Ai kaloi pikërisht mbi kokën e Ismaelit!

"E kap unë", – tha Ismaeli. Ai vrapoi drejt cepit të fushës dhe e mori topin. E pa zonjën që ishte ende duke gërmuar dheun. Dukej e lodhur.

"Tani do të jem unë portieri", – thirri Papá. "Ta shohim a mund të shënosh!"

Ismaeli u kthye me vrap dhe e gjuajti topin drejt portës. Papá u zgjat për ta ndaluar, por për pak nuk arriti.

"Gooooool!" – brohoriti Ismaeli kur topi preku rrjetën.

Shpejt kishte kaluar një orë fiks. "Është koha për të shkuar në shtëpi", – tha Papá.

Ismaeli ktheu kokën për të parë gruan që po shkulte barin e keq. *Të punosh në diell nuk është aq qejf sa të luash futboll*, mendoi ai. Ai dëshironte t'ia ngrinte humorin asaj. Pastaj i erdhi një ide.

"Papá, a nuk mendon se ajo zonja po bën një punë të mirë?" – e pyeti ai.

"Çfarë?" Papá hodhi sytë nga gruaja. "Ah, po."

"Mendoj se duhet të shkojmë t'ia themi!" – tha Ismaeli.

"Epo, duhet të nxitojmë për në shtëpi. Mamá [mami] po na pret", – tha Papá.

Ismaeli e pa gruan të fshinte ballin. Ndjenja se duhej t'i fliste u bë më e fortë. "Unë vërtet ndiej se duhet t'ia themi", – tha ai. E kapi Papán për dore dhe shkoi drejt saj.

"Mirëmëngjes, zonjë", – tha Ismaeli duke e përshëndetur me dorë.

Gruaja nuk i ngriti sytë. "Ç'dëshironi?"

Ismaeli e kuptoi se ajo nuk qe fort e lumtur. Por kjo nuk e ndali. "Doja të të thoja që po bën një punë të shkëlqyer!"

Këtë herë gruaja i ngriti sytë për ta parë.

Ismaeli buzëqeshi. "Faleminderit që kujdesesh për parkun!"

Gruaja ia ktheu buzëqeshjen. "Faleminderit", – tha ajo. Pastaj ajo buzëqeshi edhe më shumë. "Faleminderit shumë."

Ismaeli ndjeu lumturi ndërsa ecte për në shtëpi me Papán.

"Mendoj se ajo që i the ishte e rëndësishme për të", – tha Papá. "Gëzohem që ia vure veshin ndjenjës që pate."

"Edhe unë." Ismaeli u mendua për një çast. Më pas ai pyeti: "A mendon se ishte Fryma e Shenjtë?"

Papá pohoi me kokë. "Nganjëherë Fryma e Shenjtë na jep një mendim për të ndihmuar dikë. Dhe kjo është pikërisht ajo që bëre ti."

Ismaeli vuri buzën në gaz. Biseda me zonjën qe veç diçka e vogël, por ai ia bëri më të mirë ditën. Fakti që ia vuri veshin Frymës së Shenjtë ia bëri ditën më të mirë edhe atij! ●

